

# Doracak për ETIKËN

në gazetari

ЗНАМ



Doracak për etikën në gazetari

**Botues:** Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë

Gradski zid blok 13, 1000 Shkup, Maqedoni

www.znm.org.mk

**Autorë:** Tamara Çausidis dhe Zoran Bojarovski

**Dizajni dhe shtypi:** Arkus dizajn

**Autor i fotografisë:** Lubinka Brashnarska

300 kopje

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.77:174.4(497.7)

ЧАУСИДИС, Тамара

Прирачник за etikata во новинарството / автори Тамара Чаусидис и  
Зоран Бојаровски. - Скопје : Здружение на новинарите на Македонија,  
2012. - 29 стр. ; 23 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија:

ISBN 978-9989-2225-2-8

1. Бојаровски, Зоран [автор]

a) Новинарска етика - Македонија

COBISS.MK-ID 91282186

„Ky publikim është i pregaditur me ndihmën e UNESKO në suaza të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Përmirësimi i dialogut ndëretnik dhe bashkëpunimi ndërmjet komuniteteve”. Ky program zbatohet nga ana e UNDP, UNICEF dhe UNESKO, me mbështetje financiare nga Qeveria e Spanjës nëpërmjet të Fondit për arritjen e objektivave të mijëvjeçarit (MDG - F).

Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë mendime të autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet zyrtare të Kombeve të Bashkuara, UNESKO ose MDG-F.”



Doracak për etikën në gazetari

## PËRMBAJTJA:

<b>Hyrje</b> .....	<b>4</b>
<b>Vetërregullimi</b> .....	<b>7</b>
<b>Çështë Këshilli i nderit i Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë?</b> .....	<b>1</b>
<b>Kodi i gazetarëve të Maqedonisë – udhëzime dhe rekomandime</b> .....	<b>13</b>
<b>Shkeljet më të shpeshta të kodit</b> .....	<b>25</b>
<b>Parimet e gazetarisë</b> .....	<b>29</b>
<b>Shtesë ndaj Kodit të gazetarëve të Maqedonisë</b> .....	<b>32</b>
<b>Gazetarët kundër korupsionit</b> .....	<b>33</b>
<b>Për gjuhën e urretjes</b> .....	<b>35</b>
<b>Raportimi për dallimet</b> .....	<b>37</b>
<b>Udhëzime për raportimin dhe informimin për të miturit</b> .....	<b>38</b>
<b>Udhëzime për raportimin për vetëvrasje</b> .....	<b>39</b>
<b>Fjalë përmbyllëse</b> .....	<b>40</b>
<b>Bibliografi dhe linqe të dobishme</b> .....	<b>41</b>

## HYRJE

Në bashkësitë shoqarore, siç është Republika e Maqedonisë, multietnike dhe multikulturore, çdo strukturë e saj duhet të reflektojë ndjenjë adekuate të përgjegjësisë për funksionimin e kësaj bashkësie.

Kështu duhet të jetë edhe kontributi i mediave.

Sipas analizave të organizatave profesionale, të esanfit dhe ndërkombëtare, mediat në Maqedoni në vitet e fundit përballen me një krizë të thellë profesionale dhe etike.

Kërkimi i fundit i Qendrës maqedone për bashkëpunim ndërkombëtarë lidhur me besimin e qytetarëve ndaj disa institucioneve dhe veprimtarive në Maqedoni, tregon se numri i qytetarëve që nuk u besojnë mediave arrinë përqindjen fatastike prej 70 për qind.

Para më shumë se dhjetë vitesh, në prag të vitit historik të 2001-shit, gazetaria maqedone mundej të ishte krenare, sepse rezultati ishte krejt ndryshe. Atëherë afër 60 për qind e popullësisë u besonte mediave, ndërsa mediat e reja paralajmëruan pranverën e gazetarisë maqedone.

Në ndërkohë, ndikimet e ndryshme ndaj mediave bënë që gjendja ku standardet profesionale dhe gazetaria etike u shëndruan në koncepte në të cilët thuaja nuk u referohet askush. Rezultat i kësaj janë edhe konkluzionet e studimit të QMBN.

Kjo gjendje nuk është vetëm ilustrim për kapacitetet e gazetarisë në Republikën e Maqedonisë, por negativisht reflektohet edhe ndaj rolit që mediat kanë në promovimin e kohezionit social dhe dialogut mes bashkësisë të ndryshme.

Në shoqëritë multietnike dhe multikonfesionale, mediat kanë rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për ndërtimin e diversitetit kulturor të shoqërisë. Qasja gazetareske me të cilat mediat i prezantojnë grupet e caktuara shoqërore, mënyra se si fokusohen ose i përshkruajnë dukuritë negative dhe proceset, mund hapur ose në mënyrë suptile të nxisë stereotipe, etnocentrizëm, ksenofobi dhe gjuhën e urrejtjes.

Studimi i fundit i diskutit gazetaresk gjatë raportimit nga ndeshjet sportive të Shkollës së lartë për gazetari dhe marrëdhënie me publikun dhe Katedra e UNESCO për media, dialog dhe mirëkuptim të ndërsjellë, tregon se edhe retorika, repsektivisht gjuha, gjuha e medias, mund t'i prodhojnë, riprodhojnë ose forcojnë mënyrat e raportimit gazetaresk që çojnë drejt etnocentrizmit, stereotipeve, kesenofobisë dhe diskriminimit ndaj tjetrit.

Këto njohuri të analizës, si dhe shumë paralajmërime tjera për raportimin etnocentrik të mediave, hap dilemën për gjendjen e medias në vend. Por, nga ana tjetër, këto njohuri edhe njëherë i vënë në fokus të vëmendjes rolin, përgjegjësinë e profesionit të gazetarit në një shoqëri si Maqedonia.

Në këtë fokus imponohen edhe dilemat nëse gazetaria dhe pjesëtarët e saj, gazetarët, duhet të kenë ndjenjë dhe vend të veçantë në shoqëritë multietnike, veçanërisht në ato si e jona, ku këto raporte vazhdimisht janë në kufirin e tolerancës.

Mediat kanë rol vendimtar dhe përgjegjësi për promovimin e marrëdhënieve të mira mes njerëzve dhe për ndërtimin e shoqërisë demokratike. Detyra e tyre është prezentimi objektiv dhe i vërtet i bashkësive të ndryshme në shoqëri dhe të nxisin respektimin e dallimeve pavarësisht nëse ato janë të lidhura me përkatësinë etnike, fetare, seksuale ose lloj tjetër dallimesh mes individëve.

Në këtë konstelacion të një atsmofere të papjekur demokratike, ku ose nuk njihet roli i medias, ose ato vihen në funksion të agjendave politike, shprehen edhe praktikatat e këqija mediatike, të cilat i përforcojnë tensionet ndëretnike.

Atëherë shkilen standardet profesionale.

Gjendja e medias dhe ambientit shoqëror me tensioneve të theksuara ndëretnike imponon që bashkësia e gazetarëve të mendoj dhe hapur të debatojë për ndikimin që kanë mediat për nevojën për senzibilizimin e realitetit të bashkësisë multietnike.

Ajo që mund të bëhet në këtë kontekst është që të bëhet me dije për kahjet e theksuara në Kodin e Shoqatës së gazetarëve, si dhe në shumë dokumenta të këtij lloji të organizatave ndërkombëtare.

Për çdo bashkësi shetërore, e cila thirret në demokraci, ka nevojë për gazetari të pavarur, sepse pjesëmarrjes politike i nevojitet informacion objektiv dhe gjithëpërfshirës. Të shumta janë shembujt kur elitat e korruptuara që qeverisinë në shumë vende, për shkaqe ekzotike, luftojnë këto zhvillime. Prandaj, etika e gazetarisë është e rëndësishme jetike.

Por ajo që në asnjë moment nuk duhet të harohet është se gazetarët kanë përgjegjësi para opinionit publik.

Përvoja mëson se të fuqishmit patjetër të kontrollohen. Pasojë e saj është se politika bëhet ose e paprekshme ndaj gazetarisë ose përpiqet t'i korruptoj gazetarët. Ky është realiteti. Por edhe në këtë realitet, megjithatë, demokracia mund të jetojë. Patjetër të arrihet një nivel i mosbesimit të organizuar.

Pikërisht ndërlíkueshmëria dhe ndieshmëria janë stolitë e profesionit të gazetarit. Ato, bashkë me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj bashkësisë, e cila kërkon vazhdimisht të rifreskohet dhe të edukohet bashkë me frymimin e specifikave të asaj

bashkësie, e bëjnë bukurinë e profesionit i cili, me të gjitha sfidat dhe ngarkesat, ende është njëra nga më të dëshiruariat.

Duke ditur se njëra nga qëllimet e Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë është t'i mbrojë dhe promovojë standardet profesionale të gazetarisë dhe të lirisë së shprehjes, me qëllim që të sigurojë instrumenta për tu përballur me sfidat e lartpërmendura, SHGM iu drejtua Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë (UNESKO) për mbështetje në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara për përmirësimin e dialogut dhe bashkëpunimin ndëretnik.

Qëllimi kryesor i projektit është që të ngritet niveli i profesionalizmit të gazetarëve dhe të rritet niveli i bashkëpunimit mes gazetarëve të bashkësive të ndryshme. Qëllimet dytësore të peojektit janë të ofrohet mbrojtje falas juridike për të gjithë anëtarët e SHGM-së, si dhe të ngritet vetëdija e gazetarëve dhe të opinionit të gjërë për aktivitetet e SHGM dhe të Këshillit të nderit.

Një pjesë e projektit është edhe ky “doracak për etikë në gazetari”, i cili do të shërbejë për nevojat e Këshillit të nderit, si dhe për të gjithë gazetarët, të cilët gjithëherë kujdesen t'u afrohen praktikave të mira të gazetarisë, që janë të mëshiruara në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë.

Ky doracak, njëkohësisht, është një udhërrefyes praktik për gazetarinë profesionale në një mjedis multietnik, që mund të jetë e arritur e dobishme edhe për studentët për gazetari, pronarët e mediave dhe për opinionin e gjërë, i cili përmes këtij doracaku do të ketë mundësi ta njohë gazetarinë e mirë.

## VETËRREGULLIM

Askush sot nuk ka dilemë se gazetaria dhe gazetarët janë roje e vlerave të një shoqërie demokratike, por çfarë të bëhet kur ajo që shitet si produkt gazetaresk është larg të gjitha standardeve profesionale? Si të veprohet kur shpërfillen rregullat e zanatit nga ana e gazetarëve, redaktorëve ose pronarëve të medias? Si të luftojmë kundër korupsionit në radhët e gazetarëve? Me fjalë të tjera, kush përkujdeset për t'i kontrolluar rojet?

Çështja e etikës në gazetari është e vjetër thuaja sa edhe vet gazetaria. Qysh në shekullin e 17 në Gjermani është debatuar për mënyrën se si të dallohet e verteta prej gënjeshtres në publikimet e atëhershme. Sot, debate rreth gazetarisë së mirë dhe profesionale përkundër propagandës dhe shpërdorimit të fuqisë së medias në dritën e ndryshimit të industrisë së medias. Ato njëherit janë edhe garantues të gazetarësisë së mirë profesionale dhe zbatimit të tyre është mënyrë e mirë për t'u bërë dallimi mes atyre që janë dhe atyre që nuk janë gazetarë. Duke u përmbajtur, respektuar dhe promovuar kodin forcohet kredibiliteti i medias në opinionin publik dhe ato përjetojnë jo vetëm si të lira, por edhe si të përgjegjshme.

Edhe pse vetë kodet janë të ndryshme prej një nga një vend tjetër, në to janë të njohuara elementet universal për të gjithë gazetarët përkundër dallimeve kulturore, gjuhësore, kombëtare, dhe ato janë: respektimi i të vërtetës dhe saktësisë, pavarësia dhe ndershmëria dhe minimizimi i dëmit.

Praktika tregon se gazetaria e përgjegjshme dhe etike asnjëherë nuk është rezultat i zgjidhejeve ligjore dhe të rregullativave të shtetit, por i respektimit të përpiktë të kodit që është krijuar nga vetë komuniteti i medias. Kualiteti i medias nuk guxon të jetë parakusht për lirinë e tyre, vetëm media tërësisht të lira mund të jenë tërësisht të përgjegjshme.

Kontrolli dhe vlerësimi i punës së medias në bazë të kodit dhe vlerave profesionale është vetërregullim medial. Edhe pse të gjitha trupat për vetërregullim kanë të njejtin qëllim për të përmirësuar gazetarinë dhe punën e medias, mënyrat se si bëhet dallojnë (këshilla të nderit, këshilla të shtypit, ombucman në kuadër të mediave ose në nivel kombëtarë).

Qëllimi i vetërregullimit nuk është të jetë censurë ose të imponohet si vetëcensurë, por t'i prezentojë dhe t'i mbrojë parimet e gazetarisë etike, të saktë dhe objektive e cila i repsekton të drejtat e njeriut, duke respektuar në tërësi politikën redaktuese se si ajo do të preznetohet nga media.

Vetërregullimi medial, me fjalë të tjera, është mekanizëm që bënë baraspeshën mes lirisë së mediave dhe tendecës që ajo të shpërdorohet.

Në këtë kuptim, duhet të theksohet se gazetarët duhet të kenë saherë parasysh se mekanizmat për vetërregullim i kanë përcaktuar të gjitha situatat që duhet të mundësojnë realizimin e parimeve të lirisë së shprehjes, por, njëkohësisht, asnjëherë nuk guxon të harrohet se sa më të mëdha të jenë të drejtat, aq më e madhe është edhe përgjegjësia e gazetarëve që t'i mos shpërdorojnë këto të drejta.

Në një seminar në Këshillin e Evropës në vitin 1998 në Strazbur, krahas legjislacionit dhe tregut të rregulluar medatik, vetërregullimi është radhitur ndër instrumentet më të rëndësishme në industrinë mediatike. Është theksuar se vetërregullimi në masë të madhe ndihmon në krijimin e standardeve dhe se një mbikqyrje e tillë etike vepron në mënyrë preventive dhe proaktive. Është vlerësuar se vetërregullimi jo vetëm që është i nevojshëm për mediat, por edhe se është e pranueshme edhe për publikun e medias dhe për opinionin më të gjërë public, i cili reagon ndaj parregullësive të gazetarëve dhe të medias. Tubimi në Strazbur miratoi konkluzione se vetërrëgullimi i medias është vertetim specifik se sa demokratike janë sistemet mediatike dhe u sugjeron vendeve që nuk kanë trupa vetërregullimi menjëherë t'i themelojnë..



## **Përvoja në Maqedoni**

Në kuadër të Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë saherë ka ekzistuar trupi për vetërregullim. Para viteve të 90-ta quhej si Gjyq nderi, ndërsa pastaj Këshilli i nderit. Baza e tij është që të kujdeset dhe t'i promovojë parimet etike, kriteret dhe standardet e gazetarisë profesionale dhe të përgjegjeshme të theksuara në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë, i cili u aprovua në vitin 2001.

Këshilli i nderit përbëhet prej 7 anëtarëve, që zgjidhen nga ana e anëtarëve të SHGM në Kuvend zgjedhor.

## **Përvojat e të tjerëve**

**Holandë:** Këshilli aktual i mediave në Holadnë është themeluar në vitin 1960, i cili buron prej vitit 1948 kur është formuar Këshilli disiplinor i Federatës së gazetarëve.

Në vitin 1960 një incident kur është thyer embargoja për publikimin e një lajmi, rezultoi me formimin e Këshillit të medias. Qeveria nuk ka qenë e gatshme në këtë rast t'ia bart Këshillit disiplinor, sepse ai ka qenë kompetent vetëm për anëtarët e Federatës. Deri atëherë ka qenë e traditë që gazetarët ta refuzojnë anëtarësinë në Federatë para se të vijë ankesa kundër tyre para Këshillit disiplinor.

Qëndrimin që mori qeveria holandeze e inkurajoi Federatën e gazetarëve të Holadnës që Këshillin disiplinor ta shëndrojnë në Këshill të mediave. Këshilli i ri ka autorizime të shqyrtojë ankesa kundër gazetarëve padallim nëse ato janë anëtarë të ndonjë organizate apo jo, por e humbi autorizimin për të sanksionuar.

Në statutin e Këshillit është saktësuar definicioni për gazetarin: "Secilit që gazetaria i është profesion primar ose si i punësuar ose si frilenser, sidhe të gjithë ato që mbikqyrin redaktimin ose redaktojnë përmbajtje të medias...".

**Gjermani:** Këshilli i medias në Gjermani është formuar në vitin 1956. E përbëjnë 4 organizata sponzoruese: Asociacioni gjerman i botuesve të gazetave, Asociacioni gjerman i botuesve të revistave dhe të dy sindikatat e gazetarëve. Anëtarët e Këshillit janë gazetarë dhe botues, edhe pse, organizatat e botuesve delegojnë edhe avokat.

Shteti nuk përfaqësohet në Këshillë, e as në çfardo mënyrë është inkuadruar në punën e tij. Megjithatë, një e treta e buxhetit për punën e Këshillit vjenë prej shtetit si mbështetje për angazhimin për punën e suksesshme të trupit vetërregullues. Pjesën tjetër të buxhetit e sigurojnë dy organizatat e gazetarëve.

Rreth 95 për qind të shtëpive botuese të gazetave në Gjermani e kanë nënshkruar dokumentin me të cilin obligohen se do t'i botojnë vendimet e Këshillit të medias.

Deri në fund të vitit 2008 Këshilli shqyrtonte nga 700-800 ankesa në vit, ndërsa prej vitit 2009, pasi ankesat mund të bëhen edhe përmes Internetit, numri i ankesave u rrit në 1.300 në vit.

**Serbi:** Formimi i Këshillit të medias në Serbi në vitin 2009 është përshëndetur nga mediat si shpresë se përfundimisht do të kuptohet se vrap i pas kopjeve të shitura, shikueshmëri dhe profit ekzistojnë rregulla që duhet të respektohen.

Këshilli në Serbi ka 11 anëtarë të cilët i zgjedhin themeluesit si përfaqësues të tyre të drejtpërdrejt, ndërsa në Këshill zgjidhen edhe përfaqësues të opinionit publik. Sipas Statutit të Këshillit, të dy shoqatat e gazetarëve NUNS dhe UNS delegojnë nga dy përfaqësues, tre emron Asociacioni i mediave dhe një përfaqësues nga mediat lokale. Tre anëtarët tjerë, përfaqësuesi të publikut, zgjidhen me konsensus përmes shpalljes publike.

Roli kyç i Këshillit është që të zgjidh ankesat e qytetarëve lidhur me informacionet e publikuara në media duke shqiptuar paralajmërime publike. Janë paraparë edhe situata kur Këshilli mund të ndërmjetësojë ndërmjet palëve të dëmtuara dhe redaksive për të shmangur paditë në gjykata.

**Bosnja dhe Hercegovina:** Këshilli i shtypit në Bosnjë dhe Hercegovinë ka rol të rëndësishëm për forcimin e shoqërisë civile duke ofruar opsione për mbrojtjen e lirisë së njeriut përmes ankesave për tekstet e pasakta, joprofesionale dhe të gjymta në shtyp dhe mediat online. Në pajtim me parimet e vetërregullimit mediatic, Këshilli nuk mund të dënojë me të holla, të suspendojë ose të mbyllë shtëpi mediatike. Kontestet eventuale mes publikut dhe mediave i zgjedhin kryekëput me mjete gazetareske, siç janë : e drejta e përgjigjes, publikimi i korigjimit, falje dhe demant.

Për të gjitha rastet e tjera më serioze të shkeljes së të drejtave të mediave dhe të njeriut, relevante janë ligjet për mbrojtje nga shpifja.

Përparësitë e Këshillit të shtypit janë shpejtësia dhe efikasiteti, si dhe ofrimi i shërbimit falas për ankimuesit.

Këshilli i shtypit në Bosnjë dhe Hercegovinë në përbërjen e tij ka përfaqësues të mediave, gazetarëve, por edhe qytetarë..

## Ç'ËSHTË KËSHILLI I NDERIT I SHOQATËS SË GAZETARËVE TË MAQEDONISË?

Këshilli i nderit është i vetmi trup për vetërregullim i gazetarëve në Maqedoni. Detyra e tij themelore është që të kujdeset dhe t'i promovojë parimet etike, kriteret dhe standardet e gazetarësisë profesionale dhe të përgjegjeshme të përfshira në Kodin e gazetarëve të Maqedonisë.

### **Në interes të kujt punon Këshilli?**

Gazetaria e mirë dhe etike është në interes të publikut. Ajo ofron informacione të sakta, të provuara, të balancuara. Kjo gazetari është zëri i publikut. Kjo gazetari nuk është dhe nuk guxon të jetë e partizuar dhe patjetër të bëjë dallim mes fakteve, komentit dhe opinionëve – duke bërë praktikisht dallimin nga gazetaria propaganduese, të shitur ose nga tabloidet – që kënaqin disa qëllime ose interesa tjera dhe të cilat nuk respektojnë Kodin.

Duke respektuar dhe promovuar Kodin forcohet kredibiliteti i medias në publik dhe ato përjetohen jo vetëm si të lira, por edhe si të përgjegjeshme. Njëkohësisht, respektimi i Kodit e mbron edhe vetë gazetarin, sepse i jep të drejtë të mos pranojë asgjë që nuk është në pajtim me standardet profesionale dhe njëherit e privon nga gjykimi i të tjerëve, duke iu nënshtruar gjykimit të kolegëve.

### **Kush mund t'i drejtohet Këshillit?**

Çdo qytetarë ose organizatë që janë të prekura nga dukuria e gazetarisë joprofesionale dhe joetike e cila nuk është pajtim me Kodin, mund t'i drejtohet dhe të bëjë ankesë pranë Këshillit.

Duke dorëzuar ankesën për tekstet joprofesionale dhe të pasakta, qytetarët bashk me gazetarët marrin pjesë në përpjekjet për informacion të saktë, me kohë dhe profesional duke mborjtur lirinë e medias, lirinë e shprehjes dhe të drejtën e publikut për ta ditur të vërtetën.

### **Çfarë duhet të përmbajë një ankesë?**

Çdo ankesë e dorëzuar në Këshill duhet t'i përmbajë këto informacione:

Ku dhe kur është botuar teskti për të cilin ankohet (data dhe gazeta ku është botuar, respektivisht data dhe koha e

transmetimit nëse bëhet fjalë për televizion ose radio). Nëse keni mundësi dërgoni edhe kopjen e tekstit, respektivisht materialin e incizuar të kontributit të kontestuar.

Nëse teskti, kontributi vlerësohet se nuk është në pajtim me standardet profesionale kërkohet demant, plotësim i informacionit, korigjim ose falje;

Adresa juaj dhe telefoni për kontakt gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

### **Si miratohen vendimet?**

Këshilli pas pranimit të ankesës e kontakton redaksinë, respektivisht gazetarin gjegjës, duke kërkuar prej tij koment ose sqarim dhe përpiqet që rastin ta zgjidh përmes ndërmjetësimit dhe botimit të reagimit tuaj, demantit, korigjimit ose duke kërkuar falje.

Nëse nuk arrihet ujdj, Këshilli mblidhet dhe shqyrton kontributin e kontestuar, ankesën tuaj, si dhe sqarimin e gazetarit dhe do të merr vlerësim të bazuar në standardet e Kodit të gazetarëve të Maqedonisë.

Ankesa shqyrtohet në afat prej 10 ditësh nga pranimi i saj. Këshilli i nderit vendos plotëfuqishëm me shumicë të thjeshtë, nëse në mbledhje marrin pjesë të paktën 4 anëtarë – këshilltarë. Mbledhja e Këshillit të nderit nuk është publike.

### **Kush i merr vendimet?**

Këshilli i nderit përbëhet prej 7 anëtarëve që zgjidhen nga ana e anëtarëve të SHGM-së në Kuvend zgjedhor.

### **Ku duhet të dërgohet ankesa?**

Ankesat duhet të jenë të adresuara në  
SHGM – Për Këshillin e nderit, Gradski zid 13, 1000 Shkup

Tel: (02) 3298-139

Faks: (02) 3116-447

Ose në postën elektronike:

sovetnacesta@znm.org.mk, contact@znm.org.mk

Formulari i ankesave është në formë elektronike në ueeb faqen e SHGM: [www.znm.org.mk](http://www.znm.org.mk)

## KODI I GAZETARËVE TË MAQEDONISË – UDHËZIME DHE REKOMANDIME

Liria e medias është njëra nga garancitë më të rëndësishme për lirinë e shprehjes dhe ajo është element i domosdoshëm për çdo shoqëri që proklamon respektimin e të drejtave dhe lirive civile.

Liria e medias nënkupton të drejtën për “debat të lirë dhe kritik ndaj aktorëve politik, civil dhe korporativ.

Gazetarët janë ato që kontribuojnë për realizimin e të drejtës për të shprehur edhe mendimin që nuk është në pajtim me shumicën.

Ashtu si edhe çdo qytetarë, gazetari ka të drejtë për të pasur qëndrimet e tij politike, por gjatë ushtrimit të profesionit të tij ai duhet të qëndrojë objektiv.

Për të zbatuar detyrat e tij sipas standardeve të larta profesionale, gazetarët duhet t’i respektojnë parimet e Kodit të gazetarëve të Maqedonisë. Në këtë kapitull të “Doracakut për etikë në gazetari” e transmetojmë Kodin e gazetarëve me komente dhe udhëzime:

### **PARIME TË SJELLJES:**

*Liria e medias është e drejtë e pakontestueshme.*

*Detyra themelore e gazetarëve është ta respektojnë të vërtetën dhe të drejtën e opinionit për të qenë i informuar në pajtim me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.*

*Gazetarët kanë rolin të transmetojnë informacione, ide dhe mendime dhe të drejtën për të komentuar.*

*Duke respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale gjatë transmetimit të informacioneve, gazetarët do të jenë të ndershëm, objektiv (...) dhe të saktë.*

*E drejtë dhe obligim i gazetarëve është që të përpiqen të pengojnë cenzurën dhe shtrembërimin e lajmeve.*

*Duke ndjekur detyrën e tij në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë civile, gazetarët do t’i mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do ta respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë për forcimin e shtetit juridik dhe në kontrollin e pushtetit dhe të subjekteve tjera nga jeta publike.*

**D**uke informuar drejt gazetarët mbrojnë demokracinë dhe interesin publik. Kjo ndonjëherë është në kundërshtim me interesat e ndryshme grupore dhe individuale duke përfshirë edhe interesat e pushtetit, të reklamuesve dhe të atyre të pronarëve të mediave.

1.

*Gazetari ka të drejtë të qasjes së lirë deri te të gjitha burimet e informimit që janë me interes publik. Gazetari duhet të publikojë informata të sakta, të provuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale dhe nuk do të falsifikojë dokumenta. Nëse informata nuk mund të vërtetohet, ose bëhet fjalë për supozim, përkatësisht spekulim, kjo duhet të thuhet dhe të publikohet. Saktësia e informatës duhet të provohet sa më shumë të jetë e mundur..*

**G**azetari patjetër duhet ta mbrojtë lirinë e shprehjes, të ruajë pavarësinë e qëndrimeve të tij ndaj çdo përpjekjeje për të shtrembëruar ose për të çenzuruar informacionin.

- Provimi i të dhënave dhe saktësia janë imperativ moral i gazetarisë, prandaj gazetari është i obliguar ta provojë informacionin prej sa më shumë burimeve, të paktën prej dy burimeve të pavarura.
- Zgjedhja e fakteve patjetër të sigurojë informacion objektiv duke pasur parasysh të gjitha aspektet e rëndësishme të temës që trajtohet.
- Nevoja për shpejtësi asnjëherë nuk guxon të rrezikojë saktësinë, kredibilitetin dhe profesionalizimin e kontributit.
- Çdoherë duhet të përpiqet të ruhet konteksti original i të gjitha deklaratave ose pjesëve të veçuara. Raportimi gazetaresk nuk guxon ta ndryshojë kuptimin e fjalisë ose deklaratës.
- Gazetari duhet të sigurojë “palën e dytë”, respektivisht t’u jep mundësi të dy palëve të interesuara të produktit gazetaresk ta shprehin qëndrimin e tyre. Kjo edhe më tepër vie në shprehje kur gazetari shpreh dyshime ose akuza ose kur dikush është objekt i sulmit apo kritikës.
- Nëse gazetari vlerëson se informacioni i paprovuar është me interes publik, është i obliguar ta publikojë, por duke saktësuar se bëhet fjalë për informacion të pakonfirmuar.
- Gazetari mund të publikojë diçka për të cilën nuk ka edhe aq dëshmi, por për të cilën ka mjaft indikacione se është i vërtetë, respektivisht diçka për të cilën ekziston dyshim i bazuar. Dyshimi i bazuar nënkupton prezentimin e argumenteve që janë të arsyeshëm dhe që janë indikacion se diçka është e vërtetë, pa pasur dëshmi konkrete për vërtetësinë.
- Publikimi i informacioneve që kanë statusin “të bësueshme” është e mundur atëherë kur do të konstatohet se e drejta e publikut për të qenë i informuar është më e madhe sesa e drejta e respektimit të arsyeve të besueshmërisë të informacionit.
- Gazetari nuk guxon të fsheh informacione as atëherë kur ato kanë ndikim (negativ) të medias ku gazetari punon ose për pronarin e medias.

- Heshtja dhe mospublikimi i të dhënave që mund të ndikojnë në qëndrimin e opinionit është e njejtë sikur shtrembërimi i qëllimshëm ose manipulimi i vetëdijshëm me opinionin.
- Tutulli ose paralajmërimi i kontributit patjetër të jetë në harmoni me përmbajtjen e tij.

## 2.

*Nëse gazetari është penguar të arrijë deri te informacioni i kërkuar, ka të drejtë që për këtë ta informojë opinionin publik.*

- Gazetari duhet ta njoftojë publikun se është kërcënuar e drejta e opinionit për të qenë i informuar.
- Edhe atëherë kur pushteti nuk është i obliguar të përgjigjet, gazetari mund dhe duhet ta informojë opinionin se nuk ka marrë përgjigje në pyetjet për të cilat vlerëson se janë me interes publik dhe kur për këtë mund të ofrojë argumenta me peshë.
- Debatet, kritikrat dhe publikimi i lajmeve nuk guxon të pengohet nga palët që nuk janë të gatshme të japin informacion, koment ose të marrin pjesë në debate.
- Mbyllja e institucioneve, organizatave ose funksionarëve nuk mund të jetë metod për shmangien e temave dhe çështjeve me interes për publikun.

## 3.

*Gazetari do të tentojë të sigurojë publikimin e korigjimit, demantit dhe përgjigjes në rast kur do të jetë konstatuar pasaktësia e informacionit..*

- Përgjegjësia morale për pasaktësinë e informacionit bie mbi gazetarin prandaj është e rëndësishme që ai vetë të ndikojë dhe të sigurojë publikimin e demantit, korigjimit ose përgjigjes në median ku informacioni është publikuar, autori i të cilit është ai. Në këtë mënyrë gazetari mbron edhe integritetin e tij, por edhe integritetin e medias ku punon.
- Të gjitha gabimet duhet të vërtetohen dhe të korigjohen. Pranimi i gabimeve është korektësi, ndërsa fshehja është e papranueshme për dinjitetin profesional.
- E pelqyeshme është që gazetari ose media të kërkoj falje për gabimin.

- Përgjithësisht duhet të shmanget tërheqja e materialit që njeherë është publikuar në Internet, ndërsa nëse ai ndryshohet ose tërhiqet duhet qartë të saktësohet.
- Ato që kanë qenë objekt i sulmit apo kritikës duhet të kenë mundësi të përgjigjen para se kontributi të publikohet, dhe nëse kjo nuk ndodhë dhe përgjigja vjenë pas publikimit, ai duhet të jenë në masë të arsyeshme, i lidhur me temën dhe në formë korekte.
- Përgjigja mund të refuzohet, nëse pala e prekur, e hedh posht mundësinë e dhënë paraprakisht për prezetimin e vërejtjeve të tij për të njejtën çështje, pa pasur arsye objektive.
- Përgjigjet nuk duhet të jenë të përshkuara me koment polemizues me redaksinë.
- Gjykimet dhe mendimet e gazetarit nuk guxojnë të jenë objekt i demantit, por korektesa gazetareske nënkupton ofrimin e të drejtës së njerezve të japin përgjigje në rast kur mendojnë se gazetari ka gabuar.

## 4.

*Gazetari do ta bëjë të ditur burimin e informacionit, por nëse burimi kërkon të mbetet anonim, gazetari do ta mbrojë.*

- Burimi i informacionit, sipas rregullit duhet të identifikohet përveç se kur ajo mund të ndikojë ndaj sigurisë së tij ose sigurisë së palëve të treta.
- Locimi i gabuar i burimeve ose shpikja e burimeve për të prezentuar informacione të pasakta, të gjymta dhe jo sa duhet të provuara, trajtohet si shkelje e rëndë e standardeve profesionale.
- Gazetari duhet çdoherë të jetë kritik ndaj burimit të informacionit dhe t'i provojë informacionet e marra. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet kur përdoren burime anonime ose kur gazetarit i ofrohen informacione ekskluzive. Duhet rreptë të provohen motivet e informacionit të ofruar.
- Nëse gazetari pajtohet me burimin anonim, ai duhet të sigurojë që redaksia do ta respektojë, por e pëlqyeshme është që një redaktor ta dijë identitetin e vërtetë të ofruesit të informacionit.
- Përrjashtim prej rregullit për respektimin e anonimitetit të burimit janë rastet kur gazetari vjenë deri te informacioni për krim të planifikuar, kur është i obliguar të informojë kompetentët.



- E rëndësishme është që gazetari, por edhe media, me qëllim që ta mbrojnë kredibilitetin e tyre, të bëjnë të pamundurën për ta provuar informacionin edhe nga burime tjera të pavarura dhe ta përdorin burimin anonim vetëm atëherë kur nuk ka mënyrë tjetër për të ardhur deri te informacioni me interes publik..

## 5.

*Gazetari do t'i respektojë ligjet e shtetit, por nuk do të publikojë ose të fsheh asgjë që është në kundërshtim me interesin publik.*

Interesi publik përfshin informacione që mund të kontribuojnë për zbulimin e veprave kriminale, shpërdorimeve të pozitës zyrtare, rrezikimit të demokracisë, korupsionit, rasteve të padrejtësive, shkeljen e të drejtave të njeriut, diskriminimit, rrezikimit të shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, pakujdesi dhe/ose paaftësi të funksionarëve publik. Interesi publik, poashtu, inkudron edhe informacione që u ndihmojnë njerëzve të marrin vendime me karakter publik dhe pengojnë mashtrimin apo manipulimin me popullësinë me deklarata ose me veprime nga individë ose organizata..

- Liria e shprehjes është, poashtu, interes publik.
- E drejtë dhe obligim e gazetarit është të publikojë informacione për atë që ndodhë në shoqëri, t'i përcaktojë dhe t'i zbulojë çështjet që do të duhej të ishin nënshtruar kritikizmit.
- Gazetarët dhe mediat nuk guxojnë të lëshojnë pe para çfardoqoftë presioni, ngado që vjenë ai, ndërsa qëllimi i të cilëve është të pengojë debate të hapura, qarkullim të lirë të informacionit dhe qasje të lire deri te burimet..

## 6.

*Gazetari nuk guxon të përdorë median për publikimin apo për fshehjen e informacioneve për përfitime personale. Mitoja, korupsioni dhe reketi janë të huaja për profesionin e gazetarit.*

*Nuk guxon të lejohet reklamimi dhe motivet tjera komerciale të ndikojnë ndaj lirisë së informimit. Duhet të ekzistojë ndarje e qartë mes reklamimit dhe tekstit gazetaresk me ilustrim..*

Për çrënjosjen e korupsionit në profesionin e tij, gazetarët në Maqedoni miratuan deklaratë për sjellje antikorruptive si shtesë e Kodit.

- Gazetarët kurrë nuk duhet të informojnë për tema dhe çështje për të cilat ka interes personal financiar dhe të mos e përdor pozitën e tij për të siguruar privilegje që nuk janë në dispozicion të publikut.
- Çdo lloj publikimi komercial, si dhe propagandë politike që nuk janë të veçuara sakt vlerësohen si shkelje e rëndë e standardeve profesionale.

- Me reklamim të maskuar nënkuptohen të gjitha përmbajtjet propaganduese, të cilat në formën e tyre dhe mënyrën e përgaditjes i ngjajnë tesktit autentik gazetaresk, ashtu që lexuesi/shikuesi nuk mund ta dallojë funksionin e tij propagandues nga përmbajtja gazetareske. Si shembull shërben shtesat dhe tesktet për universitetet “e suksesshme” private, prodhimet e reja ose shërbimet e disa kompanive.
- Nëse raportohet për persona ose kompani që kanë aksione në media, ky fakt duhet të përmendet nga gazetari, respektivisht redaktori, njësoj sikur duhet qartë të përmendet nëse pronari i medias ka aksione në kompaninë ose organizatën për të cilën raportohet.
- Gazetarët duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm kur përpilojnë lajme për disa ndërmarrje, prodhime ose veprimtari shërbyese dhe kur përdorin kumtesa për opinion dhe material tjetër të PR shërbimet të këtyre burimeve ose nga agjencitë e marketingut që kujdesen për këto ndërmarrje dhe nuk guxojnë të harrojnë se qëllimi kryesor i këtyre materialeve është që të sigurojnë publicitet pozitiv falas, e jo informacion të saktë, të pavarur dhe objektiv.
- Kontributi duhet të publikohet si rezultat i vlerësimit dhe angazhimit të redaksisë, e jo si kompensim për reklamën.
- Gazetari ka të drejtë të marrë falas libra, bileta për ngjarje sportive, kulturore ose tjera, por nuk guxon që raportimin ta kushtëzojë me bilet falas apo libër.

## 7.

*Gazetari do ta respektojë privatësinë e individit, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik. Gazetari është i detyruar ta respektojë dhimbjen dhe vuajtjen personale.*

- Opinion ka të drejtë të dijë për punën e institucioneve dhe për njerëzit e zgjedhur për ti shërbyer interes publik, por poashtu, njerëzit kanë të drejtën e privatësisë, ndërsa ato që janë të akuzuar për ndonjë krim kanë të drejtë për gjykim të drejtë.
- Informacione për jetën private të ndonjë personi mund të publikohen vetëm nëse sjellja e atij personi në jetën private ka ndikim ndaj interesit publik. Në këto raste duhet të provohet nëse publikimi i informacionit do të mundej të rrezikojë ndonjë person tjetër.
- E drejta e opinionit për tu informuar nuk mund të jetë arsyetim për nevojën e senzacionit.

- Gazetari nuk guxon që për shkak të atraksionit të teskit/kontributit të nxisë shqetësime të pabazuara ose shpresa të bashkëbiseduesit, ose të manipulojë me ndjenjat e tyre.
- Kur raportojnë për ngjarje që kanë shkaktuar tragjedi personale, dhimbje dhe shok – gazetarët, fotoreporterët dhe kameramanet duhet të tregojnë dhimbshuri, diskrecion dhe maturi.
- Informacionet për percaktimin seksual, gjendjen shëndetësore, përkatësinë etnike apo fetare nuk guxojnë të publikohen pa leje, përveç nëse ekziston interes publik.
- Duhet të shmangët nxitja e interesit të opinionit për përshkrime grafike dhe detale për krime të kryera ose tragjedi. Të gjitha të dhënat flasin se publikimi i detaleve specifike për një krim të kryer e shton mundësinë për zbatimin e të njejtit metod.
- Fotografi dhe inçizime të viktimës duhet të shmangen, si dhe letrat eventuale lamtumirëse apo porosi.
- Raportet duhet të mbajnë llogari për familjen e viktimës, të mos ia shtojë dhimbjen, por edhe të mos ndihmojë për “anatemimin” e tyre.
- Asnjëherë nuk duhet të shpërdorohen emocionet ose ndjenjat e njerëzve, mosdija e tyre ose paaftësia për të gjykuar.

## 8.

*Mënyra e informimit në raste të fatëkeqësive, katastrofave, luftrave, tregjedive familjare, sëmundjeve, proceseve gjyqësore duhet të jenë të çliuara nga senzacionalizimi.*

*Në procese gjyqësore duhet të respektohet parimi i presumcionit të pafajsisë, të raportohet për të gjithë të involvuarit në kontest dhe të mos sugjerohet vendimi i gjykatës.*

Kur raportohet për fatkeqësi, krim, ose aksion të policisë, mediat përgjithësisht duhet të përmbahen nga publikimi i emrave, fotografive ose të dhënave tjera që do të mundësojnë identifikimin e viktimave ose aktorëve.

- Femijët dhe adoleshentët gëzojnë mbrojtje të veçantë.
- E drejta e opinionit të dijë patjetër çdoherë të vlerësohet në raport me të drejtën e personit për ta ruajtur privatësinë e tij.
- Viktimat e krimeve ose fatkeqësive kanë të drejtë për mbrojtje të veçantë për emrat e tyre. Aspak nuk është e nevojshme të identifikohen viktimat për ta kuptuar lexuesit më mirë fatkeqësinë ose krimin. Përgjashtime janë të mundshme vetëm nëse personi është i famshëm ose nëse ngjarjen e ndjekin rrethana të veçanta.

- Në rast të personave që indirekt ndikohen nga ndonjë fatkeqësi ose që nuk kanë asgjë të përbashkët me krimin për të cilin raportohet, publikimi i emrave dhe fotografive të tyre paraqet shkelje fundamentale dhe të papranueshme.
- Publikimi i emrave dhe/ose fotografive të dyshuarve, të akuzuar për vrasje, megjithatë, është e arsyeshme nëse kjo është në interes të zgjidhjes së krimit ose nëse vepra penale është kryer në publik (për shembull, kur policia publikon emër të një kriminelit të rrezikshëm që është në arrati).
- Në raste të personave zyrtar ose politikanë lejohet publikimi i emrave nëse vepra penale është e lidhur me funksionin. E njëjta vlenë edhe për personat e famshëm nëse vepra për të cilën dyshohen është në kundërshtim me imazhin publik që kanë (shembull, kur aktivisti i njohur për të drejtat e fëmijëve është pedofil dhe etj).
- Emrat dhe fotografitë e personave të zhdukur mund të publikohen, por vetëm me marrëveshje me familjen dhe organet kompetente.
- Veçanërisht duhet të mbahet llogari për presumcionin e pafajësisë gjatë raportimit për ngjarje të lidhura me krim ose gjatë raportimit prej gjykimi. Me fjalë të tjera, i akuzuari nuk guxon të shpallet fajtor para se këtë ta vendos gjykata.
- Gazetarët kanë obligim t'i mbrojnë jetën private të të akuzuarit, integritetin dhe dinjitetin e tij dhe të mos i mbështesin raportet në bazë të hipotezave për fajësinë ose pafajësinë.
- Korekte etike është të publikohet akvendim i gjyqit për procese për të cilat paraprakisht është informuar.

Raportimi i gazetarit nuk guxon të jetë mënyrë për të dënuar të dyshuarit dhe për të turpëruar ato publikisht.

9.

*Gazetari nuk guxon të intervistojë ose fotografojë fëmijë nën 16 vjeç pa pëlqimin e prindërve ose kujdestarit, përveç nëse ajo nuk është në pajtim me të drejtat e fëmijës.*

*E njëjta vlenë edhe për personat me nevoja të veçanta, që nuk janë në gjendje të gjykojnë me vetëdije të plotë.*

- Trajtimi i fëmijëve në media, përveç në kodin e gazetarëve, është e rregulluar edhe me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës, si dhe me standardet e pranuar që ndalojnë ashpër manipulimin me ndjenjat e fëmijës, insistimin për përjetimin e sërishëm të traumës dhe publikimit të identitetit të fëmijës.
- Publikimi ose mbrojtja e pamjaftueshme e identitetit të miturit (intervistë me prindërit, inçizime nga shtëpia ose mjediset e afërta), informimi për detaje të krimit, veçanërisht nëse bëhet fjalë për raste të tilla delikate siç janë

dhuna seksuale në familje, gjithëherë e nënshtron viktimën në traumë edhe më të madhe dhe e shton tragjedinë. Përgjegjësia për një traumatizim të ri është drejtpërdrejt i gazetarit dhe medias.

- Informacionet e marra nga mjekët, punëtorët social, edukatorët, mësuesit ose familjarët që drejtpërdrejt ose jo zbulojnë identitetin e të miturit, nuk guxojnë të publikohen.

## 10.

*Gazetari nuk do të krijojë me vetëdije e as që do të trajtojë informacione që i rrezikojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim në çfardo qoftë baze (nacionale, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimit seksual, politike..).*

- Detyrim i gazetarit dhe medias është që t'i mbrojë individët dhe grupet nga padrejtësia dhe diskriminimi të kryera nga organet publike dhe institucionet, nga ndërmarrjet private ose nga çdokush qoftë tjetër.
- Kodi etike dhe profesional i gazetarëve u imponon përgjegjësi të veçantë për fjalën e thënë publike. Qëndrimet e tyre janë faktor të rëndësishëm në formësimin e mendimit publik për shkak se gjuha e urrejtjes është e padenjë për etikën e gazetarit.
- Media dhe gazetari nuk duhet të publikojnë material (informacion, fotografi, mendim, koment) që ka për qëllim të përhapë armiqësi ose urrejtje, ose nëse ekziston besueshmëri e madhe se materiali i publikuar do të shkaktojë armiqësi ose urrejtje ndaj dikujt për shkak të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, bësimit, përkatësisë politike, orientimit seksual, hendikarit fizik, etj.

## 11.

*Gazetari do tu përmbahet standardeve shoqërore dhe korektësisë dhe do të respektojë dallimet etnike, kulturore dhe fetare në Maqedoni (...).*

- Përmendja e përkatësisë etnike, kombëtare, politike, gjinore ose seksuale lejohet vetëm nëse është e rëndësishme për të kuptuar në tërësi storien.
- Gazetari duhet të jetë i vetëdëshëm për temat e ndieshme etnike, kulturore, fetare dhe seksuale dhe t'i trajtojë në pajtim me ato.
- Gazetari duhet të jetë i vetëdëshëm për pasojat dhe efektet e fjalëve të tij, duhet të bëjë kujdes për zgjedhjen e tyre

dhe nuk guxon të ofendojë ose të përqesh. Gazetari profesional asnjherë nuk do të flet për persona në bazë të stereotipeve dhe paragjytimeve për racën, gjininë, moshën, fenë, përkatësinë etnike, orientimin seksual, hendikapi fizik, pamjes fizike ose statusit social.

- Gjuha e gazetarit gjithëherë duhet të jetë e matur dhe neutrale, përkundër atij që ofron konkluzione të gatshme dhe gjykime dhe është, ose kufizohet me gjuhën e urrejtjes.
- Çdoherë duhet të shmangen frazat që në vete përmbajnë konotacione shoveniste, seksiste ose të tjera diskriminuese.
- Gazetari është përgjegjës edhe për fjalën e bashkëbiseduesve, sepse përmes tij ato qëndrime dalin në opinion, prandaj është i obliguar t'i parafrzojë ose të distancohet nga fjalori ofendues, promovimi i stereotipeve ose diskriminimit.
- Kur informohet për grupe etnike, gazetari nuk guxon të harojë se ato janë të përbëra prej individëve me qëndrime dhe përvoja të ndryshme dhe nuk guxon të gjeneralizojë.

**K**ur trajtohen tema asnjherë nuk duhet të prezentohen vetëm nga një kënd ose aspekt që i tangojnë interesat e ndryshme kulturore, etnike, politike, seksuale dhe dallimet e tjera.

12.

*Plagjiatura është e papranueshme. Deklaratat nuk guxojnë të citohen pa mos theksuar burimin apo autorin.*

- Mosrespektimi i të drejtave të autorit vlersëohet si shkelje e rëndë e rregullave të etikës.
- Nesë informacioni është marrë ose parafrazuar nga ndonjë media tjetër, vepër autoriale ose studim, burimi duhet të përmendet, në të kundërtën do të trajtohet si plagjiatar, e jo për gazetar.
- Nëse për tesktin apo kontributin janë angazhuar më shumë gazetar ose bashkëpunorë kjo duhet të saktësohet.
- Obligim i gazetarit është që gjatë raportimit opinionet e drejtpërdrejta t'i publikojë përmes citatateve.
- Citatat duhet të transmetohen saktë, ndërsa ndryshimet eventuale duhet të kufizohen në gabime faktike. Gazetarët nuk kanë obligim për autorizim, por nëse pajtohen, personi i intervistuar nuk ka të drejtë t'i ndryshojë pyetjet e gazetarit, kuptimin dhe kontekstin e përgjigjeve të tij.
- Fotografitë duhet të jetën të nënshkruara me emër dhe mbiemër të autorit dhe nuk guxojnë t'u jepen personave të tretë pa pëlqimin e autorit.

13.

*Gazetari duhet të bëjë dallim mes fakteve dhe mendimeve, mes lajmit dhe komentit.*

- Gazetarët kanë të drejtë për të pasur mendimin, qëndrimin dhe vlerësimin e tij, por nuk guzojnë që mendimet e tij t'i kamuflojnë sikur të jenë fakte.
- Duhet të jetë qartë të ndara, cilët janë faktet dhe cilat informacionet, dhe cilat janë komente, hipoteza ose qëndrime të autorit për të shmangur dezinformimi dhe manipulimin me publikun.

14.

*Raportimi nga proceset policore, veçanërisht nga zgjedhjet, duhet të jenë i paanshëm dhe i balancuar. Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale nga subjektet politike..*

- Ndjekja kritike e proceseve politike dhe përdorimi i fuqisë politike apo ekonomike janë obligime kryesore të mediave.
- Propaganda për ndonjë parti politike ose opSION nuk ka asgjë të përbashkët me profesionin e gazetarit.
- Kumtesat e partive politike ose grupeve tjera dhe organizatave duhet qartë të theksohen, ndërsa përpunimi i tyre i redaksisë nuk guxon t'i ndryshojë faktet, kontekstin dhe kuptimin.
- Sfondi partiak apo ideologjik i informacionit nuk guxon të ndikojë në vendimin për publikimin e tij.

15.

*Gazetari duhet ta kultivojë gjuhën e mirëkuptimit dhe të etikës.*

*Komunikimi i pashembullt me opinionin është i papranueshëm për profesionin e gazetarit..*

- Gazetari duhet t'i ketë parasysh standardet morale të publikut të cilit i drejtohet. Gazetari nuk duhet të përdor përmbajtje të pashembullta, shqetësuese dhe pornografike në punën e tij.
- Ky parim, gjithsesi, nuk do duhej të determinojë ose kufizojë na çfardo qoftë mënyre të dejtën e autorit ta zgjedh stilin e tij të shprehjes, derisa ai nuk është ofendues dhe i pahijshëm për publikun.

16.

*Gazetari do të ruaj reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do të nxisë solidaritetin e ndërsjellë dhe pluralizmin e mendimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për të qëruar hesaspet me individë, duke inkuadruar edhe kolegët e tij.*

- Në punën e tij gazetarët duhet të përipiqen të mbajnë balance mes konkurrencës së ndershme dhe solidaritetit profesional.
- As gazetarë, e as redaktorë nuk do të guxonin të lejojnë të përplasen me kolegët e tyre përmes mediave të tyre. Një sjellje e tillë jo vetëm që ulë integritetin dhe dinjitetin e tyre, por e rrënon edhe reputacionin e profesionit të gazetarit në përgjithësi dhe ulë besimin e opinionit ndaj mediave.
- Në zgjidhjen e kontesteve me kolegët e tyre, gazetarët duhet t'i drejtohen Shoqatës së gazetarëve. Gazetari veçanërisht është i obliguar t'i mbrojë kolegët që pësojnë për shkak të aktiviteteve të tyre profesionale.

17.

*Gazetari ka të drejtë ta refuzojë detyrën e punës nëse është në kundërshtim me parimet e këtij Kodi.*

- Gazetari mund t'i kundërvihet punëdhënësit dhe të mos kryej obligimet e punës që prej tij kërkon të shkel standardet profesionale dhe për këtë duhet ta informojë Shoqatën e gazetarëve, Sindikatën, të gjitha organizatat relevante të mediave, por edhe opinionin.





## SHKELJET MË TË SHPESHTA TË KODIT

Këshilli i nderit i SHGM, të gjitha qëndrimet e tij deri tani, gjatë praktikës së deritanishme, ka shqyrtuar dhe është prononcuar për shumë ankesa për punën e gazetarëve në Republikën e Maqedonisë. Vendimet e këshillit të nderit të SHGM janë baze referuese për rastet që mund të shërbejnë si tregues i mirë për shkeljet më të shpeshta të Kodit të gazetarëve.

Në këtë kapitull do t'i veçojmë vendimet më karakteristike nga puna e deritashme e Këshillit duke veçuar nenet e Kodit dhe shembujt për mosrespektimin e tyre.

### **1. Publikimi i informacioneve të paprovuara, të pasakta, emra, të dhëna, moshë, si dhe informim tendencioz**

Shembull: Në një tekst akuzohet një kompani se ka fituar një tender të trukuar, duke cituar deklarata të përfaqësuesve të kompanive që kanë humbur tenderin. Dy ditë më vonë, në të njejtën gazetë është publikuar demant i informacionit dhe tregohet se kompania e përmendur aspak nuk ka marrë pjesë në tenderim, e as që e kishte fituar. Por edhe përkundër demantit, mediat tjera e pranojnë informacionin e pasaktë si fakt dhe mbi bazën e tij bëjnë storie tjera. Në informacionin për një problem në një shkollë, emri i drejtoreshës në media të ndryshme u lakua ndryshe: Violeta, Vesna, Dragica... duke informuar për ngjarje tragjike ku dëshmitar ka qenë një fëmijë, mosha e fëmijës tre ditë pas ngjarrjes në media të ndryshme, ndryshe transmetohet, diku 4, ndërsa diku edhe 10 vite. Në informacion për një person të arrestuar theksohet se ai është i punësuar në kohën kur në pushtet ka qenë një parti e caktuar që është tendencioze duke orientuar vëmendjen negative si një llojë qërim hesapësh politike.

### **2. Mosrespektimin e privatësisë dhe dhimbjes (informacione për gjendjen shëndetësore, preket privatësia e njerëzve të zakonshëm, publikohen fotografi të viktimave në fatkeqësi, publikohen emrat e vrasësve, bile edhe hipoteza për motivet e këtij akti)**

Shembull: Në një fatkeqësi komunikacioni ku vdiq nëna dhe bija, shtetas të Republikës së Serbisë, opinioni pati mundësi të shikojë filmime të trupave të djegur të cilët me llopatë qenë mbledhur nga rruga. Filmime me trupat e turistëve të mbytur nga Bullgaria, të cilët vdiqën pas përmytjes së anijes "Ilinden" në Ohër, qenë prezentuar si "ekskluzive" dhe televizionet bënin gara se kush do të transmetojë pamje sa më tmeruese të viktimave. Kur D.S. një 19 vjeçare nga Kumanova vendosi të

vetvritet, gjithë Maqedonia përmes televizioneve, ndërsa të nesermen edhe nëpër gazeta, pati mundësi të kuptojë emrin dhe mbiemrin e saj të plotë, ta shikojë fotografinë e saj, bile edhe të dëgjojë për motivet e mundshme të vetvrasjes.

## SI TË SHMANGEN GABIMET

*Deri sa jeni në teren/raporton/ e ndërton storien:*

- ▶ Pyete burimin, njerëzit me të cilët bisedon dhe ke ndërmend ti citosh, parafrazosh, saktë ta thonë emrin e tyre, funksionin dhe të gjitha të dhënat relevante për storien. Përcakto emrat dhe të dhënat dhe për personat që përmenden në storie.
- ▶ Inçizo ose mbaj shënime derisa interviston.
- ▶ Mbështeti të gjitha pohimet me burime relevante. Mos lejo të jesh vetëm transmetues i deklaratave dhe “mbajtës i mikrofonit”.
- ▶ Ruaj të gjitha linqet dhe çdo gjë që të ndihmon në investigimin.

### **3. Gajtë informimit për abuzimin me të mitur – publikim i emrave ose të informacioneve të pakonfirmuara për fëmijë, por edhe për autorin e dyshuar, edhe pse vepra nuk është konfirmuar. Fotografi, inçizime dhe emra të fëmijëve viktime.**

Shembull: Nje television kombëtarë, duke raportuar për një rast të ri të dhunës dhe pakujdesit ndaj një fëmije në fshatin e Strugës Llabunishtë, nuk i bëri ballë dëshirës për senzacionalizëm – ta intervistojë nënën e viktimës, ta inçizojë shtëpinë e viktimës, hapësirat e brendshme dhe të jashtme të shtëpisë, por edhe vet voglushen nga shpina, duke zbuluar praktikisht identitetin e saj për njerëzit e fshatit. Poashtu, shumë shpesh, mediat hyjnë në përshkrime të hollësishme dhe të pabesueshme të ngjarjes që vlerësohet si abuzim me një fëmijë, duke publikuar emrin e personit të dyshuar, ndërsa gazetari hynë në rolin e gjykatësit, hetuesit, jo rallë edhe të psikologut, duke analizuar motivet, ndërsa i zbulon edhe qëllimet.

Një sekuençë nga një kontibut i tillë: “Dje rreth orës 16 në fshatin e Koçanit Morodvis, një 37 vjeçar (me emër dhe mbiemër) ka sulmuar dy vajza të mitura duke i privuar nga liria me qëllim të abuzimit seksual. Vogëlushja 11 vjeçare dhe shoqja e saj 10 vjeçare duke luajtur në një rënë nga dhomat e shëpisë nga jashtë vjenë i dyshuari duke hyrë nga dritarjadhe me litar i ka lidhur për karige të kuzhinës, duke iu shkaktuar lëndime të lehta në duar (...).

#### **4. Mosrespektim i parimit të presumcionit të pafajësisë. Shpersh akuzat policore ose kumtesat janë burime të vetme të dhënash, ndërsa fjala i dyshuar nuk përmendet, duke krijuar përshtypjen se personi për të cilin informohet është fajtor. Në këtë mënyrë mediat “gjykojnë” para se të mbarojë procesi gjyqësor.**

Shembull: Thuaja të gjitha mediat e publojnë informacionin se ‘policia në Manastir ka arrestuar 32 vjeçarin (emri dhe mbiemri i plotë) për shkak të trafikimit të drogës’. Shumë media në mënyrë jokritike e transmetojnë informacionin e marrë nga policia dhe thonë se “kanë arrestuar narko bosin kryesor”, duke injoruar faktin se bëhet fjalë për të dyshuar. Shpesh për mediat akuzat e policisë nuk mjafton që duke publikuar identitetin e plotë të personit të japësh kualifikime si “mbret i nëntokës”, “pedofil monstër”, “maniak lokal” dhe të ngjashme. Shembuj të këtillë ka shumë.

#### **5. Gjuha fyese dhe stereotipe për pakica ose për grupe sensitive**

Shembuj me tituj dhe paralajmërime në mediat maqedone: “Maqedonët nuk duan narkomanë, pijanec dhe homoseksual!” “Vehabijtë rrahin policë dhe gay!”, “Homoseksualë kanë “birësuar” një djalosh!”, “Luten romët të mos bëjnë punë ciganësh!”.

Jo rrallë gjatë raportimit për vepra kriminale përmendet përkatësia nacionale e autorit duke forcuar stereotipet dhe paragjykimet për atë bashkësi. Kështu, në një kontribut televiziv transmetohet lajmi për arrestimin e personave të dyshuar për sulmin ndaj tre hendbollistëve në Hungari, krejtësisht pa nevojë theksohet se të dyshuarit janë me përkatësi rome. Poashtu, në një tekst me tutull “Fëmijë lypës kthehen në Shqipëri”, një gazetë e thekson faktin se përkatësia etnike e fëmijëve, si dhe konstatimi se “më shpesh këta fëmijë jo vetëm që lypin, por edhe janë kryes potencial të veprava kriminale”.

### **SI TË SHMANGEN GABIMET**

*Para se ta dorëzosh storien/raportin provoji:*

- ▶ Emrat
- ▶ Funkcionet
- ▶ Numrat
- ▶ Lokacionet, toponimet
- ▶ Saktësinë dhe prejardhjen e deklaratave
- ▶ Definicionet
- ▶ Gabimet gramatikore dhe drejtëshkrimore

## 6. Gjuha e urrejtjes dhe jotolerancës ndaj pjesëtarëve të bashkësive të tjera, ndaj kundërshtarëve politik dhe atyre që mendojnë ndryshe

Shembull: Nën maksën e qasjes shkencore dhe historike, mediat e transmetojnë gjuhën e Gegëve (Shqiptarëve) si “komb kriminogjen që është shpërngulur për të kryer terror dhe dhunë kundër elementit sllavë për të mos mundur të ngrej kryengritje dhe rebelime”. Në emsione kontaktive shikuesve dhe dëgjuesve u jepet hapësirë të transmetojnë qëndrime radikale për pjesëtarët e bashkësive tjera, për kundërshtarët politik ose kundër atyre që mendojnë ndryshe. Ndarjet dhe etiketimet në ‘patriot’ dhe ‘tradhtarë’ me lista për ‘likuidim’ me shprehje të llojit: “Çdo maqedon do të turpërohej me një akt të tillë”, pohimi “kapacitetet e tyre i vënë në shërbim të ambasadores greke”, janë shembuj të mostolerancës, nxitjes dhe gjuhës së urrejtjes, e cila është e patolerueshëm për gazetarinë profesionale.



## PARIMET E GAZETARISË

Bibliografia botërore e titujve të shtypur dhe elektornik me rekomandime për gazetari të mirë është jashtëzakonisht e pasur dhe e llojlojshme. Si pjesë e konceptit të këtij doracak, autorët e tij vendosën t'i transmetojnë "parimet e gazetarisë", të përcaktuara nga Qendra kërkimore për gazetari të mirë PJU nga Uashingtoni, SHBA.

### 1. Detyrim i parë i gazetarëve është e vërteta

Në themelin e bashkësive demokratike është që qytetarët e saj të kenë qasje deri te faktet e besueshme dhe te sakta të vendosura në një kontekst të arsyeshëm dhe të kuptueshëm. Gazetaria është njëri nga instrumentet që mundësojnë këtë. Gazetarët nuk janë në kërkim pas të vërtetës në kuptimin absolut filozofik, por në kërkim të vërtetës në kuptimin praktik. Kjo "e vërtet gazetereske" është një proces që fillon që nënkupton mbledhje dhe verifikim i fakteve. Gazetarët duhet të jenë aq sa është e mundur më transparent në raport me burimet dhe metodat që përdor. Kjo do t'i mundësojë publikut të formojë vlerësim vetiak për informacionin. Bile edhe në botën e shumësisë së mendimeve, saktësia është themeli mbi të cilin ndërtohet tërë historia e gazetarisë – konteksti, vlerësimi, komentet, kritika, analiza dhe debatet.

### 2. Në vend të parë janë qytetarët

Derisa kompanitë mediatike janë përgjegjës para themeluesve ose aksionerëve, bile në një kuptim edhe para partnerëve komercial (reklamuesit), gazetarët ekskluzivisht duhet të jenë lojal ndaj qytetarëve dhe ndaj interes të përgjithshëm publik. Ky përkushtim ndaj qytetarëve është themel edhe për kredibilitetin e medias. Këtë obligim ndaj qytetarëve nënkupton se gazetarët janë specie e të gjitha strukturave të shoqërisë. Injorimi i disa grupeve të qytetarëve është hapi i parë drejt përjashtimit të tyre nga bashkësia. Peëvojat e industrisë modern mediatike konfirmojnë se ndërtimi i besimit në bazë të lojalitetit ndaj qytetarëve, reflektohet edhe ndaj përfitimeve financiare për kompaninë mediatike. Në këtë kuptim, pronarët ose aksionerët e mediave duhet ta kultivojnë lojalitetin e gazetarëve ndaj qytetarëve..

### **3. Verifikimi i fakteve është zemra e gazetarisë**

Gazetarët mbështeten në një nga procedurat më qënore të punës së tyre – verifikimi, provimi i informacioneve. Kur u paraqit koncepti i objektivitetit të profesionit, kjo nuk nënkuptonte se gazetarët janë të çliruar nga paragjykimet. Por, objektiviteti dhe balanci janë të nevojshëm për të mos cënuar vërtetësinë e informacionit për shkak të paragjykimeve kulturore dhe personale të gazetarëve. Metodologjia është objektive, e jo gazetari. Kërkimi sa më shumë të jetë e mundur e dëshmitarëve, aq sa më shumë të jetë e mundur e burimeve adekuate, hapa e mundësive për mendime nga më shumë palë, janë hapa që i demostrojnë standardet e gazetarisë objektive. Këto instrumenta të verifikimit dhe provimit, e veçojnë gazetarin nga format e tjera të komunikimit, siç janë propaganda, fiksioni ose zbavitja.

### **4. Pavarësi prej atyre për të cilët raportohet**

Pavarësia është parakush qënësor i gazetarisë, bazë e besueshmërisë të gazetarisë. Pavarësia e frymës dhe mendimit, bashkë me pozicionin e gazetarisë për neutralitet, janë parime në fokus të gazetarisë. Duke promovuar pavarësinë dhe neutralitetin, gazetarët nuk duhet ta kapërcejnë kufirin i cili do t'i çojë në arogancë, elitizëm, izolim dhe nihilizëm.

### **5. Pavarësia si pasqyrë para qendrave me pushtet**

Gazetaria ka kapacitetet dhe potenciale për të qenë qeni roje para atyre që kanë pushtet dhe atyre veprimi i të cilëve në masë më të madhe ndikon ndaj qytetarëve. Gazetarët kanë obligim ta kultivojnë këtë qëndrim dhe të mos e shpërdorin për qëllime personale dhe për pëfitime jolegale komerciale të kompanisë mediatike.

### **6. Gazetaria siguron hapësirë për kritikë publike dhe kompromise**

Mjetet e informimin janë platform për debat publik dhe ky rol i përgjegjshëm qëndron në themelet e privilegjeve qytetare. Debatit publik është nevojë e bashkësisë, veçanërisht kur ajo mbështetet mbi fakte, e jo mbi paragjykime dhe hipoteza.

Debate duhet të sigurojë hapësirë të barabartë për qëndrime dhe interesa të ndryshme, si dhe t'i vejë ato në kontekst, e jo t'i theksojë konfliktet e debatit. Saktësia dhe vërtetësia kërkojnë prej atyre që e formojnë opinionin publik gjithëherë ta kenë parasysh interesin e përgjithshëm.

## **7. Ajo që është e rëndësishme të jetë interesante dhe relevante**

Shprehja e gazetarit ka qëllim. Ajo është më shumë se mbledhje dhe katalogizim i informacioneve. Për shkak të ekzistencës së vet, gazetaria duhet të balancojë mes asaj që e dinë se e do publiku dhe asaj që i njejtë publik nuk mund ta parashikojë, ndërsa është i rëndësishëm për atë. Efekti i një storie të gazetarit është e destinuar nga kujdesi që publiku i kushton dhe nga niveli hapjes së shtigjeve të reja. Në këtë kuptim gazetarët duhet vazhdimisht të shikojnë se cili informacion ka vlerë më të madhe dhe cila është mënyra më e mirë ajo të prezentohet. Gazetaria që udhëhiqet nga interesi i përgjithshëm gjithëherë është e arritur për të mirën e bashkësisë, derisa gazetaria e fokusuar në informacione triviale dhe të pavlera bëhet njëri nga gjeneratorët e shoqërive triviale.

## **8. Lajmet duhet të jenë të plota dhe proporcionale**

Insistimi lajmet të jenë proporcionale në raport me domethënien e tyre është, poashtu, baza e kërkimit pas të vërtetës. Gazetaria është si kartografia: ajo krijon harta të cilat qytetarëve u ndihmojnë me sukses të gjinden në sistemin shoqëror. "Fryerja" e ngjarjeve për shkak të senzacionalizimit, përcmimi i burimeve tjera, stereotipizimi dhe qëndrimi i paarsyeshëm negativ, nuk krijojnë harta të besueshme. Hartat duhet t'i përfshijnë lajmet për të gjithë në bashkësi, e jo vetëm për ato që janë dominant si demografi apo për shkaqe tjera. Për të arritur këtë, e nevojshme është të afirmohen dallimet në redaksitë.

## **9. Gazetarët duhet të ushtrojnë vazhdimisht vetëdijën personale dhe ndjenjën për të mirën dhe të keqen**

Çdo gazetar duhet të ketë etikë personale dhe përgjegjësi – kompas të vetin moral. Çdo gazetar duhet të jetë i gatshëm, nëse këtë e kërkon ndershmëria dhe saktësia gazetareske, t'u jep mundësi dallimeve. Mediat duhet t'i kultivojnë pavarësinë e mendimeve dhe lirinë e shprehjes të atij mendimi dhe t'i inkurajojnë gazetarët ta praktikojnë këtë. Për ta kuptuar një shoqëri të theksuar multietnike, siç është e jona, stimulimi i dallimeve është nevojë e patjetërsueshme.

# SHTOJCË

NDAJ KODIT TË GAZETARËVE  
TË MAQEDONISË



## GAZETARËT KUNDËR KORUPSIONIT

Duke u nisur nga Kodi i gazetarëve të Maqedonisë dhe duke ndjekur nga parimet e raportimit objektiv, të paanshëm dhe të vërtetë, si dhe nga Kushtetuta e Maqedonisë dhe parimet se gazetarët duhet të jenë korigjues të pushtetit, e drejtë dhe obligim i gazetarit është që të luftojë kundër shpërdorimit dhe korupsionit në profesionin e tij dhe më gjërë në shoqëri.

- Çdo dhuratë ose shërbim që mund të ndikojë mbi objektivitetin e informacionit vlerësohet si korupsion.
- Çdo përdorim i profesionit të gazetarit, funksionin, autorizimin publik dhe detyrën dhe pozitën zyrtare, për të krijuar favore për veten ose për ndonjë subjekt tjetër, trajtohet si korupsion në gazetari.
- Si burime të mundshme të korupsionit çmohen: bartës të funksioneve publike, funksionarë të zgjedhur apo të emëruar, biznesmen, parti politike, organizata arsimore, shëndetësore, fetare, sportive dhe kulturore, organizata qeveritare dhe joqeveritare, shtëpi mediatike dhe individë.
- Si korupsion i drejtpërdrejt vlerësohet dhënia, marrja dhe nxjerra e përfitimeve joligjore material dhe tjera për realizimin e një favorit për gazetarin ose për median.
- Për korupsion të fshehur vlerësohet: organizimi i udhtimeve, seminareve, këshillimeve. Favorizimi i një grup gazetarëve dhe redaksive si eskortë të delegacioneve zyrtare, si dhe ofrimi i shërbimeve dhe mjeteve nën kushte të favorshme me qëllim që të përfitohen gazetarët për të heshtur faktet relevante për publikun, si dhe tekstet pozitive afirmative.
- Nxjerrja e përfitimit material dhe jomaterial nga ana e gazetarit me shantazh për të publikuar ose jo një informacion të caktuar, i cili mund të dëmtojë një subjekt të caktuar, poashtu, vlerësohet si korupsion. Për eliminimin e korupsionit në profesionin e tyre gazetarët në Maqedoni angazhohen për parimet në vijim:
- Esnafi i gazetarëve i kundërvihet përpjekjeve për të koruptuar kolegët e tyre dhe publikisht do t'i denoncojë këto raste nëse ekzistojnë. Lufton për çrrënjosjen e korupsionit në radhët e veta.
- E trajton si të huaj punën e gazetarëve me çfardo qoftë angazhimi politik.
- Angazhohet për pengimin e diskriminimit të organeve të shtetit ndaj mediave.

- Angazhohet për transparencë të pronësisë dhe punës finansiare të mediave.
- Insiston në zbatimin e përpiktë të Ligjit për qasje të lirë deri te informacionet me karakter publik.
- Bashkëpunon me organizata dhe institucione relevante, media, sektorin joqeveritar dhe privat, ekspertë vendor, të huaj dhe të pavarur dhe bashkësinë ndërkombëtare..

Duke pasur parasysh statusin social të gazetarëve në Maqedoni dhe mundësinë për mito dhe korupsion, çdo gazetar duhet të pyetet çka kërkohet nga ai në shkëmbim kur do t'i ofrohet ndonjë dhuratë, udhëtim ose ndonjë lloj tjetër i favoreve dhe shërbimeve. Esnafi do të distancohet prej gazetarit për të cilin do të dëshmohet se ka pasur sjellje korruptive dhe publikisht do ta dënojë. Çdo gazetarë dhe media që i përmbahet këtyre parimeve e gezojnë mbështetjen e organizatës profesionale.



## PËR GJUHËN E URREJTJES

Kodi etik dhe professional i gazetarëve u imponon përgjegjësi të veçantë për fjalën publike. Qëndrimet e tyre janë faktor i rëndësishëm në formimin e opinionit publik, prandaj gjuha e urrejtjes nuk korespondon me etikën e gazetarit.

*“Gazetari nuk do flet me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskrimin në asnjë bazë” (Neni 10 I Kodit të sjelljes).*

Kjo do të thotë se media dhe gazetari nuk duhet të publikojnë material, informacione, fotografi, mendime, kemente) që kanë për qëllim përhapjen e armiqësisë ose urrejtjes, ose nëse besohet se materiali i publikuar do të shkaktojë armiqësi ose urrejtje kundër dikujt për shkak të racës së tij, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, përkatësisë politike, orientimit seksual, hendikarit fizik etj.

Mirëpo, ekzistojnë mjaft dilema rreth definimit të nocionit “gjuhë e urrejtjes” që mund të mos njihet ose të devalvohet me atë që në opinion nuk do të njihet si i rrezikshëm.

Ekziston tendencë që çdo dukuri e gjuhës fyese ose të manifestimit publik të jokulturës dhe mostolernacës ndaj të ndryshmes, më shpesh, mendimit politik, të quhet “gjuhë e urrejtjes”, duke devaluuar terminologjinë dhe humb kuptimin. Nga ana tjetër, shprehje shume të qartë të gjuhës së urrejtjes definohej si shpërthim i fuqishëm emotiv i patriotizmit ose të manifestimit të fuqishëm të ndjenjës kombëtare, që sërish rezultojnë me devaluimin dhe humbjen e kuptimit të kësaj dukurie shumë të rrezikshme në diskursin publik. Por më shpesh ato që e përdorin gjuhën e urrejtjes përpiqen ta tregojnë si “liri të shprehjes”.

Për çdo gazetarë është e rëndësishme të dijë se liria e shprehjes shkon deri aty derisa nuk i cënon lirinë, të drejtat dhe sigurinë fizike të njerëzve të tjerë, grupeve shoqërore ose individëve.

Edhe pse nuk ekziston një definicion i vetëm për atë se çka është gjuha e urrejtjes, është shumë e mundshme që të definohej disa elemente që karakterizojnë. Përgjithësisht vlerësohet se gjuha e urrejtjes është “çdo deklaram që ka për qëllim të ofendojë, fyej, frikësojë ose të nxisë dhunë ose veprim të dëmshëm kundër një personi ose grupi në bazë të përkatësisë së tyre politike, racore, sociale, gjinore, seksuale ose ndonjë veçorie tjetër”.

Një definicion tjetër thotë: Me gjuhën e urrejtjes nënkuptohet propagandë ose arsyetim për krime, si dhe nxitje për dhunë

ndaj grupeve shoqërore dhe anëtarëve të tyre, në bazë të ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike, gjinisë ose orientimit seksual”.

Si gjuhë e urrejtjes trajtohet edhe “prezentim dhe transmetim i ideve për superioritetin apo inferioritetin e nje grupi shoqëror ose pjesëtarëve të saj, si dhe përdorim i simboleve që nxisin urrejtje dhe e theksojnë superioritetin ose inferioritetin e grupeve shoqërore dhe pjesëtarëve të saj”.

### **Si të njihet gjuha e urrejtjes?**

Në esencën e gjuhës së urrejtjes është ndarja në NE ku bënë pjesë ai që e praktikon këtë lloj të gjuhës së urrejtjes dhe ithatrët e tij dhe ATO, TË TJERËT që i nënshtrohen kësaj gjuhe. Në gjuhën e urrejtjes nuk ekziston tolerancë, respektim të tjetrit dhe veçorisë së tij qoftë në bazë të përkatësisë fetare, politike, kombëtare, seksuale, gjuhësore, kulturore ose ndonjë tjetër. Ai është i destinuar të nxisë urrejtje ndaj tjerëve, atyre që nuk bëjnë pjesë në grupin NE.

Derisa në shoqëri relativisht stabile dhe të pjekura demokratike gjuha agresive nuk shkakton turbulenca të mëdha, ndërsa e njejta gjuhë në shoqëri jostabile, shkakton tensione dhe pasoja të padëshirueshme.

Në historinë e re gjuha e urrejtjes është e pranishme në media në rajonin e Ballkanit dhe shikohet si katalizator i gjakëderdhjeve në luftrat e ish Jugosllavisë, ndërsa si shembull eklatant për nxitjen e krimeve të luftës është aktiviteti i Radios RTML (Radio Television Libre des Milles Collines) në Ruandë. Drejtori i kësaj radioe në vitin 2003 nga Gjykata për krime lufte u dënua me burgim të përjetshëm sepse me emisionet e tij kontribuojë për përshkallëzimin e urrejtjes dhe gjenocidit që Hutit kryen ndaj pjesëtarëve të fisit Tutsi në luftën e vitit 1994..

## RAPORTIMI PËR DALLIMET

**Fjalët janë të rëndësishme!** Gazetari duhet të di me çfarë fjalësh emërton një bashkësi. Testi më i mirë për këtë është çështja nëse kjo bashkësi don të emërtohet ashtu? Nëse termi është fyes, ai nuk guxon të përdoret pavarësisht prej argumenteve që ju duken valide dhe të zakonshme.

**Respektoje atë që për të tjerët është e çmuar dhe e rëndësishme!** Njhi besimet, botëkuptimet, tabutë e të tjerëve, kulturën, bashkësitë etnike ose grupet. Gazetari nuk guxon të manifestojë mosrespektim, pavarësisht nëse kjo bëhet verbale apo vizuele të dallimeve fetare, etnike, seksuale, politike apo tjera padallim prej qëndrimit të tij personal ndaj këtyre çështjeve dhe dukurive.

**Sterotipet janë armiq të gazetarisë profesionale!** Çdo individë është i ndryshëm. Asnjëherë mos e portretizo sjelljen e nje njeriu sikur të jetë karakteristik për tërë grupin apo bashkësinë.

**Mos merr pjesë në krijimin e imazhit negative për ndonjë grup apo bashkësi të caktuar!** Të jesh i ndryshëm, më ndryshe nga shumica, të jesh pakicë shumë shpesh është barë e madhe për njerëzit. Gazetari nuk guxon të merr pjesë në rritjen e kësaj barre. Asnjëherë mos bëj që ndonjë bashkësi ose grup të përjetohet si sinonim i terrorizmit, mosdisciplinës qytetare, primitivizmit, sëmundjes.

**Gjej histori pozitive!** Mediat mund drejtpërdrejt të ndikojnë për forcimin e bashkimit, kohezionit në një shoqëri nëse në portretizimin e njerëzve nisen nga të kuptuarit se të gjithë njerëzit janë të njejtë, të gjithë kanë shqetësime të njejta, shpresa dhe nevoja padallim përkatësisë së tyre kulturore, etnike, politike, seksuale, gjinore ose përkatësie tjetër.

Me zbulimin e historive pozitive për tolerancë, solidaritet dhe humanizëm, mediat e zgjojnë më të mirën te njeriu njësoj sikur duke theksuar dhe insistuar vetëm në dallimet, të asaj që është ndryshe, duke e treguar në kontekst negativ si pamundësi për të qenë bashk ose si shkak për konflikt dhe mostolerancë, e ushqejnë opinionin publik me stereotipe, paragjykime që çojnë drej diskriminimit dhe shoqërisë së ndarë.

**Jini të informuar për atë që do të informosh!** Studio, lexo, informo krejt për lëndën e raportimit tënd. Mos iu qas me paragjykime, stereotipe ose informacine të gabuara ndaj pjesëtarëve të bashkësive të ndryshme, sepse deshëm apo jo, mungesa e informacioneve do të prodhojë informim të pasaktë dhe joobjektiv. Provo se si shprehen emrat – moskujdesi në transmetimin e të dhënave personale flet për mungesë respekti.

**Mos inform vetëm për atë që ka ndodhur, por edhe pse!** Mos u përqëndro vetëm në atë që ka ndodhur. Sqaro ngjarjen. Njohja e shkaqeve dhe konteskti shpesh e ndryshon opinionin publik për ndonjë dukuri ose ngjarje.

**Mos përdor formulime “ne” dhe “ato”!** Në këtë shoqëri të gjithë kanë të drejta dhe përgjegjësi të barabarta. Të jesh pjesëtarë i një bashkësie tjetër, të jesh ndryshe nga shumica nuk do të thotë se dikush ka më pak të drejta dhe përgjegjësi prej tjerëve.

## UDHËZIME PËR RAPORTIM DHE INFORMIM PËR TË MITUR

Në Kodin e gazetarëve është theksuar se gazetari “nuk guxon të fotografojë ose intervistojë fëmijë nën 16 vjeç pa pëlqimin e prindit ose kujdestarit, përveç nëse ajo është në pajtim me të drejtat e fëmijës” (neni 9). Mirëpo, e rëndësishme është që të theksohet se trajtimi i fëmijëve në media, përveç se në Kodin e gazetarëve, rregullohet edhe me Konventën e OKB për të drejtat e fëmijës, si dhe me standardet e pranuar që ndalojnë ashpër manipulimin me ndjenjat e fëmijës, insistimi për përsëritjen e përjetimit të traumës dhe publikimit të identitetit të fëmijës.

Publikimi ose mbrojtja e pamjaftueshme e identitetit të të miturit (intervistë me prindët, inçizime nga shtëpia dhe mjedisit përreth), informimi për hollësi nga krimi, veçanërisht kur bëhet fjalë për raste delikate siç është abuzimi seksual dhe dhuna në familje, gjithëherë e ekspozon viktimën në një traumë edhe më të madhe dhe smadhon tragjedinë. Përgjegjësia për një traumatizim të ri është drejtpërdrejt e gazetarit dhe medias.

Përfaqësuesit e institucioneve që përkujdesen për mbrojtjen e fëmijëve (siç janë shërbimet sociale, policia, organizatat joqeveritare) ose prindët dhe familja e viktimës që duan ta alarmojnë opinionin për këto raste, shpesh nuk janë të vetëdijshëm për ndikimin e medias dhe për mënyrën e punës së tyre. Të dhënat që i japin, jo rallë e zbulojnë identitetin e fëmijës, por gazetari nuk guxon ta shpërdorë qëllimin e tyre të mirë ose mosdijen. Informacionet e mara nga mjekë, punëtorë social, edukatorë, mësues ose familjarë që drejtpërdrejt apo jo zbulojnë identitetin e të miturit, nuk guxon të publikohen.

Disa prej udhëzimeve dhe parimeve të Federatës ndërkombëtare të gazetarëve për raportim për çështje ku involvohen fëmijët janë sa vijon:

- Saktësi dhe ndjeshmëri kur informohet për çështjet e fëmijëve;
- Shmangien e publikimit të fotografive dhe materialit tjetër që mund të çenojë ose të dëmtojë fëmijën;
- Të mos përdoren stereotipe dhe paraqitje senzacionaliste në kontributet televizive lidhur me fëmijët dhe në këtë mënyrë ta zbusin dëmin ndaj fëmijëve;
- Të mos përdoret identifikimi vizual ose tjetër të fëmijëve me përjashtim kur kjo është qartë me interes publik.

## UDHËZIME PËR RAPORTIM PËR VETËVREASJE

Lidhja mes vetëvrasjes dhe medias është e ditur dhe e pranuar moti. Çdo informacion për marrjen e qëllimshme të jetës i nxit vetëvrasësit potencial për një tragjedi të re. Studimet dëshmojnë se shumica e njerëzve që mendojnë për të bërë vetëvrasje, në fakt, nuk janë të sigurt se duan të vdesin. Njëri nga faktorët që ndonjë person i tillë mund ta çojë në vetëvrasje është edhe publiciteti që atij akti do t'i japin mediat. Grupi më i rrezikuar janë pikërisht të rinjtë dhe adoleshentët.

Shembull:

1. Nëpër raportet mediatike për vetëvrasje duke i vënë flakën vetes në vitin 1972 në Britanin e Madhe, vitin në vijim janë regjistruar 60 vetëvrasje nga zjarri ishim më shumë se pritej.
2. Në vitin 1980 televizioni gjerman raportoi hollësisht për vetëvrasjen e një djaloshi 19 vjeçar duke u hedhur nën tren. Në 70 ditët në vijim është regjistruar numër i madh i vetëvrasjeve të kryera në të njejtën mënyrë.
3. Pas raportit dramtik për vetëvrasje në Vjenë, numri i vetëvrasjeve në 18 muajt në vijim ishte 22, për dallim vetëm 9 nga tre vitet e mëparshme..

**Mediat mund të ndihmojnë për uljen e numrit të vetëvrasjeve.** Prandaj në botë është miratuar praktika për vetëvrasje përgjithsisht, veçanërisht për personat anonim thuaja aspak edhe nuk raportohet. Nëse kjo bëhet, tema trajtohet me kujdes të veçantë dhe diskrecion, media nuk guxon ta zbulojë identitetin e plotë, edhe më pak fotografi të viktimës.

- Në pajtim me nenin 7 dhe 8 të Kodit, gazetarët janë të obliguar ta ruajnë privatësinë e personit dhe të mos reportojnë me senzacionalizëm në raste të vetëvrasjeve, sepse bëhet fjalë për tragjedi familjare.
- Fotografi apo filmime të viktimës duhet të shmangen, si dhe letra dhe porosi që eventualisht mund të ketë lënë.
- Duke bërë me gisht për motivet sociale të vetëvrasjes, siç është papunësia, problem me shkollën ose në fund të lidhjes dashurore, mund të kuptohet si porosi deri të të gjithë që kanë problem të ngjashme se vetëvrasja është njëra nga zgjidhjet e mundëshme.
- Shprehje kolorite, qëndrim pozitiv ndaj aktit ose qasje senzacionaliste, veçanërisht nëse bëhet fjalë për personalitet të famshëm që është edhe idhull i të rinjëve, mund të nxisë për vetëvrasje.

Por, kujdes dhe diskrecion në trajtimin e vetëvrasjeve si temë, nuk kërkohet vetëm për prevencion të vetëvrasjeve, por edhe të shmangët traumatizimi i sërishëm i viktimave, ndërsa në vetëvrasjet asnjëherë nuk ka vetëm një viktimë. Viktima është vetëvrasësi, por viktima janë edhe ato që jetojnë: prindët, metrat, vëllëzërit, shikët dhe të gjithë që në një mënyrë kanë qenë të lidhur me viktimën dhe të cilët do të duhet të jetojnë me atë ngjarje të tmershme në kujtesën e tyre.

## FJALË PËRMBYLLËSE

Derisa punuan në përgaditjen e këtij doracak, autorët e tij vazhdimisht patën dy parime sipas të cilëve duhet të udhëhiqen gazetarët që përipiqen drej standardeve të larta profesionale. Parimet “je gjithëherë i alarmuar” dhe “mëso tërë jetën”.

Edhe pse ky doracak për shumicën e kolegëve është një përmbledhje e gjerave të ditura, mirësia që udhëhiqet prej parimit “je gjithmonë i alarmuar” do t’i çojë drejt nevojës çdoherë, edhe një herë dhe vazhdimisht, të përkujtohen se parimet e gazetarisë së mirë nuk janë vetëm për në letër. Ato janë këtu për ne për t’i zbatuar vazhdimisht dhe asnjehere të mos i harojmë. Çdo ditë e punës së gazetarit mund lehtë t’i kalojë në rutinë, dhe kur do ndodh kjo, rutinë, verbohesh shqisat dhe hapet mundësia për kurthet që i kërcënohen sjelljes etike.

Ky rrezik i profesionit shmanget me parimin “mëso tërë jetën” dhe nga mirësia që çdo ditë, nga secila detyrë gazetareske të mësohet diçka e re. Ky doracak e ka këtë qëllim: t’i përkujtoj profesionistët gazetarë se duhet të jenë me mendje të hapur për të gjitha njohuritë dhe arritjet e reja të profesionit.



## BIBLIOGRAFI DHE LINQE TË DOBISHME

Doracak për gazetar, redaktor përgjegjës Risto Popovski, Civil, Shkup 2011

Etika në gazetari në Evropën Juglindore, Studim i Rrjetit për profesionalizimin e mediave në vendet e Evropës Juglindore (SEENPM), Instituti maqedon i medias, Shkup 2005

Media: Biznesi në etikë, etika në biznes, Studimi i Rrjetit për profesionalizimin e mediave në vendet e Evropës Juglindore (SEENPM), Instituti maqedon i medias, Shkup 2005

Doracak për raportimin për dallimet – Mr. Marina Tunteva, Shkolla e lartë për gazetari dhe marrëdhënie me publikun, Shkup 2011

Bëhu gazetar – Branko Gerovski, Matica makedonska, Shkup 2005

The Ethical journalism initiative – Aidan White, International Federation of Journalist, Brussels 2008

Journalism as a public good – Aidan White and John Chapman, International Federation of Journalist, Brussels 2011

Professional Journalism and Self-Regulation , editor Remzi Lani UNESCO 2011

Etika në media (Shembuj dhe kontraverse) – Luis Alvin Dej, Media, Beograd 2004

Free but not independent , Matthias Barner, Konrad Adenauer Sttifung International reports 2011

Human rights and changing media landscape, foreword by Thomas Hammamberg, Council of Europe 2011

Gjuha e urrejtjes në media, Petar Atanaskoviq, Hanna Blank, Censura Novi Sad 2009

The Media Self-Regulation Guidebook - Miklós Haraszti, OSCE 2008

Reporting Diversity - Geoff Elliott, Society of Editors, 2005

Etika e fjalës publike, Grup autorësh Beograd 2004

Freedom of the press - where to draw the line? Michael Kunczik

Media between warmongers and peacemakers, Cees J. Hamelink University of Amsterdam, The Netherlands

Hyrje në dijen për median dhe komunikimin - Michael Kunczik I Astrid Zipfel ,Friedrich Ebert Stiffung, Zagreb 2006

Kodi i gazetarëve dhe vetërregullimi, Trupi gazetar për vetërregullim, Podgoricë 2009

Besimi në Maqedoni, MCMS, 2011

## LINQE::

The Ethical Journalism Initiative

<http://ethicaljournalisminitiative.org/en>

Projekt i Federatës ndërkombëtare të gazetarëve për gazetari etike

Media Diversity Institute (MDI)

<http://www.media-diversity.org/>

Journalism.org

[http://www.journalism.org/resources/ethics\\_codes](http://www.journalism.org/resources/ethics_codes)

BBC guidelines

<http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/>

Standardet etike dhe rregullat redaktuese të servisit publik britanik

EthicNet

<http://www.bbc.co.uk/editorialguidelines/>

Përmbledhje e kodeve etike të disa vendeve evropiane

The New York Times Company Policy on Ethics in Journalism

[http://www.nytimes.com/press/guild\\_represented.html](http://www.nytimes.com/press/guild_represented.html)

Rregulla për gazetari dhe redaktor të New York Times

WORLD ASSOCIATION OF PRESS COUNCILS (WAPC)

[http://www.wapconline.org/lang\\_eng/](http://www.wapconline.org/lang_eng/)

Organizata botërore e Këshillave të shtypit

Alliance of Independent Press Councils in Europe

<http://www.aipce.net/news/>

Lidhja e Këshillave të pavarura të shtypit në Evropë

Society of Professional Journalists

<http://www.spj.org>

Shoqata e gazetarëve profesionist SHBA

racak për

**KËN**

ZETARI



Në anën e gazetarisë profesionale që nga viti 1946

[www.znm.org.mk](http://www.znm.org.mk)